VENDIM
Nr. 97, datë 12.2.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË RAPORTIMIT, AFATEVE DHE KOHËS SË PARAQITJES SË RAPORTEVE NGA SUBJEKTET E PËRFSHIRA NË TRANSFERIMET NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE TË KONTROLLUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 37, pika 2, dhe 38, pika 2, të ligjit nr. 46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky vendim miraton formatet e raportimit, përcakton afatet dhe kohën e paraqitjes së raporteve para dhe pas transferimit të mallrave nga të gjitha subjektet, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre transferimet ndërkombëtare të mallrave/teknologjive, të cilat janë objekt i ligjit nr. 46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i ndryshuar.

Neni 2
Raportimi para kryerjes së transferimit

Subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, në një afat kohor deri 24 (njëzet e katër) orë përpara kryerjes së transferimit për çdo parti malli, të aplikojnë nëpërmjet portalit *"e-Albania"* për njoftimin përpara kryerjes së transferimit, sipas formatit të raportimit në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 3
Raportimi pas kryerjes së transferimit

1. Subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, në një afat kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e kryerjes së transferimit për çdo parti malli, të dërgojnë në Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), nëpërmjet portalit *"e-Albania"*, kopje të dokumentacionit të mëposhtëm:
a) licencë eksporti/importi, të lëshuar nga vendet e huaja;
b) dokument transporti ndërkombëtar (CMR, AWB);
c) deklaratë doganore;
ç) faturën e mallit.
2. Pas kryerjes së transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara në një afat kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, subjektet e përfshira në këto transferime duhet të paraqesin në AKSHE, nëpërmjet portalit *"e-Albania"*:
a) për licencat e eksportit DVC, certifikatën e mbërritjes së mallit në destinacion;
b) për licencat e importit, deklaratën e mbërritjes së mallit në destinacion.
3. Subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, të cilat janë pajisur me licencë importi/eksporti, çdo 6 (gjashtë) muaj të vlefshmërisë së licencës së importit/eksportit, të aplikojnë nëpërmjet portalit *"e-Albania"* për dërgimin e raportit lidhur me

situatën e transferimeve të mallrave të përcaktuara në këto dokumente, sipas formatit të raportimit në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 4

Dispozita të fundit dhe kalimtare

1. Kërkesat, procedurat administrative dhe formatet e raportimit që preken nga ky vendim do të vijojnë të kryhen sipas mënyrës ekzistuese deri në momentin që përfundojnë zhvillimet teknike për pritjen e aplikimeve në sistemin e përmirësuar të menaxhimit të informacionit për AKSHE-në.

2. Formatet e aplikimit, të përcaktuara në nenin 2 dhe në pikën 3, të nenit 3 të këtij vendimi, në momentin që përfundojnë zhvillimet teknike për pritjen e aplikimeve në sistemin e përmirësuar të menaxhimit të informacionit për AKSHE-në, do të integrohen dhe do të plotësohen nga subjektet në portalin *"e-Albania"*.

3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

UDHËZIM

PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË RAPORTIMIT PËR TRANSFERIMIN E MALLRAVE TË KONTROLLUARA

1. Në kutinë ku është vendosur "*Numri dhe data e licencës*" përcaktohet numri dhe data e licencës që i referohet ky raportim.

2. Në kutinë ku është vendosur "*Subjekti.....*" përcaktohet subjekti që po kryen raportimin.

3. Në kutinë ku është vendosur "*Emërtimi i mallrave të kontrolluara*" përcaktohet emërtimi i mallrave për të cilat është marrë licenca.

4. Në kutinë ku është vendosur "*Sasia e mallrave*" përcaktohet sasia e mallrave për të cilat është marrë licenca.

5. Në kutinë ku është vendosur "*Itinerari i lëvizjes"* përcaktohet itinerari i kryer nga nisja në vendin e origjinës/eksportues deri në pikën doganore hyrës/dalëse.

6. Në kutinë ku është vendosur "*pika doganore hyrës/dalëse*" përcaktohet pika doganore në Republikën e Shqipërisë ku do të importohet/eksportohet malli.

7. Në kutinë ku janë vendosur "*të dhënat për mjetet e transportit"*, përcaktohen të dhënat e mjetit (lloji, targat) që kryejnë transportin e mallrave.

8. Në kutinë ku është vendosur "*vendi i nisjes/origjina*" përcaktohet se nga do të nisen mallrat që kërkohet të transferohen.

(Logoja e subjektit)

LICENCË nr. ... datë ……..
"Subjekti …….....…..."

Njoftimi përpara kryerjes së transferimit

Emërtimi i mallit		**Artikulli 1**	**Artikulli 1**
Sasia e mallit të livruar			
Itinerari i lëvizjes			
Pika doganore hyrëse/dalëse			
Të dhënat për mjetet e transportit			
Vendi i nisjes/origjina			

Lidhja nr. 2

UDHËZIM
PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË RAPORTIMIT PËR TRANSFERIMIN E MALLRAVE TË KONTROLLUARA

1. Në kutinë ku është vendosur "*Numri dhe data e licencës*" përcaktohet numri dhe data e licencës që i referohet ky raportim.
2. Në kutinë ku është vendosur "*Subjekti.....*" përcaktohet subjekti që po kryen raportimin.
3. Në kutinë ku është vendosur "*Emërtimi i mallrave të kontrolluara*" përcaktohet emërtimi i mallrave për të cilat është marrë licenca.
4. Në kutinë ku është vendosur "*Sasia e mallrave*" përcaktohet sasia e mallrave për të cilat është marrë licenca.
5. Në kutinë ku është vendosur "*Vlera e mallrave*" përcaktohet vlera e mallrave për të cilat është marrë licenca.
6. Në kutinë ku është vendosur "*Sasia e mallit të livruar"* përcaktohet sasia e mallrave për të cilat janë livruar nga sasia totale e licencës.
7. Në kutinë ku është vendosur "*Vlera e mallit të livruar*" përcaktohet vlera e mallrave për të cilat janë livruar nga vlera totale e licencës.
8. Në kutinë ku është vendosur "*Kompania e transportit*" përcaktohet emri i kompanisë e cila kryen transportin e mallrave.
9. Në kutinë ku është vendosur "*Numri dhe data e procesverbalit të marrjes së mallrave në dorëzim/certifikatës së shpërndarjes së mallit*" përcaktohet dokumenti që konfirmon marrjen në dorëzim në rast importi dhe dokumenti që konfirmon shpërndarjen në rast eksporti.
10. Në kutinë ku është vendosur "*Totali i sasisë dhe totali i vlerës*" bëhet shumatorja e vlerës dhe sasisë së livruar për artikujt sipas licencës për çdo 6-mujor.

(Logoja e subjektit)

LICENCË nr. ... datë ……..
"Subjekti ....."

Situata e gjendjes së veprimtarisë së transferimeve ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara çdo 6 muaj

		6-MUJORI I PARË	6-MUJORI I DYTË
Emërtimi i mallit		**Artikulli 1**	**Artikulli 1**
Sasia mallit sipas licencës			
Vlera e mallit sipas licencës			
Sasia e mallit të livruar			
Vlera e mallit të livruar			
Shteti fundor			
Subjekti transportues			
Procesverbal i marrjes së mallrave në dorëzim nr. … /datë (rast importi) Certifikata e shpërndarjes së mallrave në destinacion nr. … /datë (rast eksporti)			

Totali i sasisë	**0**
Totali i vlerës	**0,00**